

Letërnjoftimi i Komunës së

PRIZRENIT

2014

Maj, 2015



Fakte


- Më 2014, Komuna e Prizrenit kishte buxhet prej 33 milion eurove, një rritje prej afro 1.5 milion eurosh në krahasim me vitin 2013.
- Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 34.07% të të hyrave të përgjithshme.
- Komuna e Prizrenit në administratë komunale ka të punësuar 365 punonjës, apo një shërbyes civil për 499.9 banorë. Bazuar në mesataren në shkallë vendi, e cila është një shërbyes civil për 278 banorë, del se Prizreni ka më pak të punësuar në krahasim me popullsinë që ka.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 2263 persona, prej tyre 2059 mësime dhënë. Në Komunën e Prizrenit raporti nxënës/mësime dhënë është 35.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 480 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Prizrenit është 380.1. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Prizreni gjatë vitit 2014 ka pasur 4801 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Prizren rreth 2.63% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Prizrenit funksionojnë 10948 biznese.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 627 biznese të reja.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 198 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Prizrenit z. Ramadan Muja gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 29 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 17%, mesatarja në shkallë vendi është 24%.

2 Qeverisja komunale

Në zgjedhjet e fundit lokale (2013) qytetarët e komunës së Prizrenit ia besuan votën për të tretën herë z. Ramadan Muja nga radhët e PDK-së.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 66,904 apo 44.0% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Ramadan Muja (PDK) ka marr 53.78%, ndërsa kundër kandidati i tij Eqrem Kryeziu (LDK) ka rezultuar me 46.22%.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 10 ulëse, LDK 9 ulëse, AAK – LDD 4 ulëse, LVV dhe KDTP me nga 3 ulëse, NDS, Vakant dhe PK me nga 2 ulëse dhe KTAP, AKR, CDU, Nisma Qytetare për Prizrenin, PD dhe G.I.Srpska me nga 1 ulëse.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Prizrenit në bazë të zgjedhjeve 2013



3 Buxheti i Komunës së Prizrenit

Më 2014, Komuna e Prizrenit kishte buxhet prej 33 milion eurove, një rritje prej afro 1.5 milion eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 3108 punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 11.6 milion euro, një rënie prej 3.5 milion në krahasim vitin paraprak.


Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Prizrenit dhe kategoritë kryesore buxhetore



Instituti GAP

Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Prizrenit ishin 5.3 milion euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me dy vitet paraprake.


Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Prizrenit 2011-2015



Instituti GAP


Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 34.07% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitet tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Prizrenit radhitet e dyta, pas Prishtinës, sa i përket mbledhjes së të hyrave të tatimit në pronë. Ajo ka arritur të mbledh më shumë të hyra se sa komuna si Ferizaj, Peja, Gjilani, Gjakova, etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



Sa i përket shpenzimeve për telefoni mobile dhe dreka zyrtare kanë shënuar ngritje në krahasim me një vit më parë, ndërsa kategoria për telefoni fikse ka shënuar ulje, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.


Grafikoni nr.7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Instituti GAP

Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2014 për rrymë elektrike ka shpenzuar 636,000 euro, apo 73,100 euro më shumë se sa viti paraprak.


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Prizreni e ka përmbyllur me 3108 të punësuar në sektorin publik, 30 punonjës më pak se në vitin e kaluar.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Prizrenit




Komuna e Prizrenit në administratë komunale ka të punësuar 365 punonjës, apo një shërbyes civil për 499.9 banorë. Bazuar në mesataren në shkallë vendi, e cila është një shërbyes civil për 278 banorë, del se Prizreni ka më pak të punësuar në krahasim me popullsinë që ka.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 2263 persona, prej tyre 2059 mësimdhënës. Në Komunën e Prizrenit raporti nxënës/mësimdhënës është 35.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Prizrenit



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 480 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Prizrenit është 380.1. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Numri i bizneseve aktive të regjistruara në komunën e Prizrenit është 10948 , prej të cilave 770 kan veprimtari prodhuese. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 627 biznese të reja, një numër më i vogël se ai i vitit paraprak. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 198 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese tregtare.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014




Instituti GAP

6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Ramadan Muja gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 29 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Muja ka arritur të realizoj 17% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

